


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.02.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-4680/16, për z. Ali Arifi, Anëtar i Bordit në Kompaninë Rajonale të Ujësjiellësit "Hidromorava" Sh.A - Gjilan, për shkak se zyrtari i lartë publik e ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Ali Arifi, Anëtar i Bordit në Kompaninë Rajonale të Ujësjiellësit "Hidromorava" Sh.A - Gjilan, dhe njëkohësisht menaxher (person i autorizuar) në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Zyrtari i lartë është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimi të kësaj shkrese kemi njoftuar me fakte zyrtarin e lartë për kufizimin e përcaktuar shprehimisht në Ligjin nr.04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, neni (15 paragrafi 1), në të cilin shprehimisht thuhet:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, anëtar i ndonjë organi menaxhues apo kontrollues i ndërmarrjeve private".

Zyrtari i lartë është deklaruar se brenda afatit ligjor do të largohet na funksioni menaxherial në biznes privat, për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/596/17), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë është larguar nga funksioni menaxherial në biznesin privat NNT "Komfori". Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)



Shaip Havolli
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit